

Ky dokument përfshin informacionin kryesor për investitorin mbi këtë SIK. Dokumenti nuk është material marketingu. Dhënia e këtyre informacioneve kërkohej me ligj, për t'ju ndihmuar të kuptoni natyrën dhe risqet që shoqërojnë investimin në këtë fond. Ky dokument i vihet në dispozicion investitorëve pa pagesë. Ju këshillohet ta lexoni, në mënyrë që të informoheni përpara se të merrni vendimin për të investuar ose jo. Dokumenti i bën referencë informacionit të pasqyruar në Prospektin e Fondit. Kuotat/aksionet e SIK nuk janë depozita dhe nuk janë të siguruar nga skema e sigurimit të depozitave, investimi në SIK nuk është një investim i garantuar, SIK nuk bazohet në përkrahjen e ndonjë subjekti jashtë tij për garantimin e likuiditetit apo stabilitetin e vlerës neto të aseteve dhe risku i humbjes së principalit duhet të përballohet nga investitori.

Të dhënat identifikuese të SIK

Lloji: **Fond Investimi**
Emërtimi: **"ABI FLEX EURO"**
Shoqëria Administruese: **"ABI INVEST SH.A"**

Karakteristikat kryesore të produktit

Investimi në fond kryhet nëpërmjet blerjes së një numri kuotash për të cilat Fondi çdo ditë publikon një çmim. Ky çmim përlogaritet në bazë të vlerës së tregut të të gjitha aseteve në zotërim kundrejt numrit të përgjithshëm të kuotave në zotërim të klientëve në fond. Diferenca mes çmimit të ditës dhe atij të hyrjes në fond përbën kthimin nga investimi të klientit.

- SIK nuk mbështetet në një tregues referencë (benchmark)

Objektivat dhe Politika e Investimit

Qëllimi i investimit të Fondit është realizimi i një rritje të moderuar të kapitalit në një periudhë afatmesme, nëpërmjet investimeve në klasa ndryshme aktivesh, duke përzgjedhur strategji të përshtatshme diversifikimi.

Informacion rreth Fondit të Investimit

- Monedha baze e Fondit është EUR. Emetimi dhe shlyerja e kuotave bëhet në monedhën EUR.
- Të ardhurat e fondit nuk shpërndahen por ri-investohen.
- Shuma minimale e investimit në fond është 500 EUR.
- Cmimi fillestar për kuotë është 100 EUR
- Shlyerja e kuotave të fondit mund të bëhet në çdo kohë nga ana e investitorit me kërkesë të tij. Shlyerja e tyre bëhet brenda afatit ligjor prej 7 ditësh.

Horizonti i Investimit

Në mënyrë që të arrihen objektivat e performancës së fondit, afati minimal i rekomanduar për investimin është 5 vjet. Për shkak se fondit investon në një sërë instrumentash financiarë si: obligacione, apo aksione, apo sipërmarrje të investimeve kolektive që investojnë në këto instrumenta) cmimi i kuotave të fondit mund të ketë luhatshmëri të lartë. Për strukturën e plotë të investimit të synuar, ju lutem referojuni Prospektit të fondit.

Fondi nuk duhet të përdoret si një llogari rrjedhëse, por si një mënyrë investimi afatmesme dhe afatgjatë me qëllim sigurimin e një kthimi të kënaqshëm dhe diversifikimin e aktiveve. Qëndrimi shumë i shkurtër në fond mund të rezultojë në një kthim të pakënaqshëm ose kthim negativ.

Rekomandim: Fondi ABI FLEX EURO mund të mos jetë i përshtatshëm për investitorët të cilët planifikojnë të shlyejnë kuotat e tyre brenda afatit 5 vjeçar.

**Për më tepër informacion mbi objektivat dhe politikën e investimit jeni të lutur ti referoheni prospektit të ABI FLEX EURO*

Kategoritë kryesore të aktiveve

Kategoritë e aktiveve ku investon fondit janë (obligacione, aksione, instrumenta të tregut të parase, depozita bankare, kuota apo aksione në fonde të tjera investimi). Menaxherët e fondit do të vlerësojnë ecurinë e tregjeve ndërkombëtare të kapitalit, si edhe trendet kryesore të këtyre tregjeve. Gjatë kryerjes së investimeve fondit do të ketë si qëllim diversifikimin e portofolit, në klasa dhe lloje të ndryshme aktivesh. Aktivët e fondit investohen në instrumente financiare që i përkasin kategorive si në vijim: Obligacione qeveritare si dhe obligacione të emetuara nga shoqëri tregtare të listuara dhe pranuar për tregtim në tregje të rregulluara në BE, SHBA, Zvicër, Britaninë e Madhe, Kanada, Australi, vendet e paqësorit, Republikën e Shqipërisë, vendet e rajonit, vendet në zhvillim (emerging markets) në Europë, Lindjen e Mesme, Afrikë, Amerikën Latine apo Azi, si edhe kuota apo aksione të sipërmarrjeve të tjera të investimeve kolektive të cilat investojnë aktivët e tyre në këto lloj instrumentash. Obligacionet mund të jenë standarte, ose të nënrenditura (subordinated). aksione të shoqërive tregtare, kuota apo aksione të sipërmarrjeve të tjera të investimeve kolektive të cilat investojnë aktivët e tyre në aksione, pjesë përbërëse e bursave të: (a) vendeve të zhvilluara të tilla si BE, SHBA, Zvicra, Kanadaja, Britania e Madhe, Australia apo vendet e paqësorit apo (b) vendeve në zhvillim (Emerging Markets) në Europë, Lindjen e Mesme, Afrikë, Amerikën Latine ose Azi. Sipërmarrje të investimeve kolektive të cilat investojnë aktivët e tyre në tregun e metaleve të cmuara. Instrumenta të tregut të parasë dhe ekuivalentë cashi. Politika e investimit Që të arrihet objektivi i investimit fondit do të synojë të investojë rreth 55% të aktiveve në tregun e obligacioneve 30% në tregun e aksioneve, 5% në tregun e metaleve të cmuara, si dhe 10% në instrumenta të tregut të parasë ose cash. Fondi mund të përdorë marrëveshjet e riblerjes për menaxhimin e likuiditetit, si edhe instrumenta derivativë për tu mbrojtur nga risku.

Profili i riskut dhe përfitimi

Treguesi i riskut sintetik dhe përfitimit ka për qëllim ti japë investitorit një ide mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës. Treguesi i riskut sintetik dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel risku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Për shkak të natyrës së investimeve të fondit, të cilat synojnë një portofol të investimeve të ndarë në instrumenta borxhi dhe aksione, Fondi ka një profil risku mesatar dhe është subjekt i një luhatshmërie më të lartë se sa një fond i thjeshtë obligacionesh. Profili i parashikuar i riskut të fondit i përket kategorisë së katërt të treguesit të riskut sintetik dhe përfitimit. Ky nivel i treguesit është rezultat i aplikimit të politikës së investimit të fondit me të dhënat historike të normave të interesit dhe të tregut të kapitalit për 5 vitet e fundit.

- Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e riskut në të ardhmen.
- Kategoria e treguar e riskut dhe e përfitimit nuk garantohej se do të mbetet e pandryshuar dhe kategoria e riskut me kalimin e kohës mund të ndryshojë.
- Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa risk.

Paraqitje narrative e risqeve të rëndësishme për SIK

- **Risku i kredisë:** Nënkupton situatën kur një emetues i titujve të borxhit në portofolin e fondit ndodhet në kushtet e paaftësisë paguese dhe si rrjedhojë nuk paguan detyrimet e tij në formën e kuponit apo principalit çka do të kishte një impakt negativ mbi vlerën e asetëve të Fondit. Edhe kur instrumentat e investimit zgjidhen me kujdesin dhe përgjegjshmërinë e duhur, është e pamundur që risku i kredisë të përjashtohet plotësisht.
- **Risku i likuiditetit** ka të bëjë me mungesën e tregtueshmërisë së një instrumenti financiar në portofolin e fondit, dhe pamundësisë për tu shitur ose blerë, shpejt dhe pa ndikuar cmimin e instrumentit në treg. Si rezultat shoqëria administruese mund të haste vështirësi në lidhje me detyrimin për të shlyer kuota për shkak të mungesës së likuiditetit në treg, dhe pamundësisë për të shitur instrumentat financiare në portofolin e fondit.
- **Risku i palës tjetër ose palës së lidhur** Kjo kategori e riskut përfaqëson mundësinë që shlyerja në një sistem transfertash nuk përmbushet si duhet nga kundërpartia e cila mund të mos paguaë, ose mund të vonojë pagesën. Risku i shlyerjes lidhet me mos marrjen e shumës korresponduese pas përmbushjes së një transaksioni.
- **Risku operacional** është risku i humbjes nga procedura të brendshme të papërshtatshme dhe nga mosfunksionimi në lidhje me sistemet dhe stafin e shoqërisë administruese ose palës së lidhur e cila kryen disa funksione të deleguara për shoqërinë administruese, ose që rezulton nga ngjarje të jashtme dhe që përfshin risqe ligjore, risqe dokumentacioni dhe risqe që rezultojnë nga procedurat e tregtimit, shlyerjes dhe vlerësimit, të cilat zbatohen nga fondi; Vjen nga gabimet të sistemeve dhe njerëzore të personelit brenda shoqërisë administruese, nga ekzistenca e proceseve të brendshme të papërshtatshme (apo mos-ekzistenca e proceseve të përshtatshme) etj.

Komisionet dhe Tarifat që paguani përdoren për të shlyer kostot e administrimit të SIK, përfshirë kostot e marketimit dhe shpërndarjes së tij. Këto komisione ulin rritjen e mundshme të investimit Tuaj.

Tarifa e hyrjes në Fond	Nuk mban tarifë hyrjeje	Të njëhershme
Tarifa e daljes nga Fondi	Nuk mban tarifë daljeje	Të njëhershme
Tarifa e Administrimit	deri në 2.00% e VNA në terma vjetore	Të vazhdueshme
Tarifa e Depozitarit	Sipas marrëveshjes me palëve	Të vazhdueshme
Tarifa e AMF	0.05% e VNA në terma vjetore	Të vazhdueshme
Komisione për shit-blerjen e asetëve të Fondit	Sipas kushteve të punës të tregut ku kryhet transaksioni	Të vazhdueshme
Tarifa e Auditimit vjetor të Fondit	Sipas marrëveshjes me palëve	Të vazhdueshme


Në asnjë rast, shuma e kostove të listuara më sipër nuk mund të tejkalojnë maksimumin prej 3.50% të Vlerës Neto të Asetëve të Fondit. Shifrat bazohen në shpenzimet e fondit të vitit dhe se kjo shifër mund të ndryshojë nga viti në vit. Në të nuk përfshihet tarifa e performancës, duke përjashtuar rastin e komisioneve dhe tarifave për hyrje dhe dalje të paguara nga SIK, kur blihen dhe shiten kuota/aksione të SIK.

Performanca e kaluar e Fondit

Performanca e shkuar shërben vetëm për qëllime informative dhe nuk përfaqëson premtim apo garanci për performancën e fondit në të ardhmen. Performanca e treguar në grafik është kthimi neto i fondit, pasi është zbritur tarifa e vazhdueshme vjetore.

Fondi ka nisur aktivitetin më 18.11.2021.

Nga themelimi deri më 31 Dhjetor 2021, Fondi ABI FLEX EURO ka realizuar një kthim të pa anualizuar prej 0.152%. Ky kthim shërben vetëm si indikator i performancës për ate periudhë që është përcaktuar.



Informacione Praktike

- Banka Depozitare është Credins Bank
- Kopje të prospektit dhe raporteve më të fundit të ecurisë së Fondit mund të gjenden në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë administruese: www.abinvest.al, si dhe pranë degëve të Bankës Amerikane të Investimeve.
- Cmimi i kuotës së fondit publikohet çdo ditë në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë administruese: www.abinvest.al, ku mund te gjeni informacion më të detajuar mbi fondin.
- Regjimi tatimor në fuqi në Republikën e Shqipërisë aplikohet mbi të ardhurat e realizuara, të cilat rezultojnë nga diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së kuotave në fond.Fondi mund të paguajë tatim në burim si rezultat i regjimit tatimor të vendeve ku investohen aktivet e fondit.
- ABI INVEST sh.a. është përgjegjëse e vetme për çdo informacion/deklaratë të përfshirë në këtë dokument që është çorientues, i pasaktë ose në kundërshtim me pjesët përkatëse të prospektit te fondit.
- Ky fond është i licencuar ne Republikën e Shqipërisë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. ABI INVEST sh.a është e licencuar në Republikën e Shqipërisë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.
- Ky dokument me informacionin kryesor për investitorin është i saktë në datën e publikimit 02.02.2026